



Republika e Kosovës/ Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality
DREJTORIA PER KULTURË RINI DHE SPORT



11 Nr. 400/01-10228/22
Datë: 17/05/2022
Dragash

THIRRJE PUBLIKE

1. Të gjitha Organizatave Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Dragashit, programi i punës i së cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës, Trashëgimisë, Turizmit dhe Rinisë dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Dragashit të aplikojnë për mbështetje financiare:

Ne fushën e Kulturës dhe Turizmit

- ✓ Vlerat kulturore dhe ruajtja e folklorit dhe manifestimet e Komunës
- ✓ Promovimi i Trashëgimisë kulturore dhe Turizmi

Ne fushën e Rinisë

- ✓ Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore në zhvillimin e aktiviteteve specifike për të rinjtë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në nxitjen e aktiviteteve në fushat e ndryshme

Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare:

1. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projektet nga fusha e kulturës dhe rinis.

Vlerësimi profesional do të bëhet nga komisioni profesional prej 5 anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas rregullores për kushtet, Kriteret për Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Vlerësimi do të bëhet sipas:

1. Plotësimi të kushteve administrative të aplikimit
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes
3. Kapacitetit të dëshmuar organizativ dhe menaxhues

4. Vazhdimësisë së realizimit të programit për afirmimin ndërkombëtarë të Komunës së Dragashit
5. Cilësisë artistike të projektit;
6. Origjinalitetit të projektit.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:

- Formulari i aplikacionit për projekt/ program
- Formulari i propozim-buxhetit
- Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë
- Formulari për konflikt interesi
- Dokumenti i identitetit (fotokopje)
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së dhe Numri Fiskal (fotokopje)
- Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit
- Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore ndaj ATK-së, jo më të vjetër se 6 muaj
- * Dëshmi të implementimit projekteve/ programeve të ngjashme

4. Formulari për aplikim mund të merret në web-faqen e Komunës dhe mund të dorëzohet nga **18/05/2022 deri më 07/06/05/2022** (15 ditë punë). Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dhe CD duhet të dorëzohen te Zyra e Protokollit (Arkivi) Nr. 1, në ndërtesën e Komunës së Dragashit, për: Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport.

Aplikimet

OJQ-të në kuadër të kësaj thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt.

1. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Dragashit.

2. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e aplikimit.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovë dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Dragashit- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantet, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Dragashit.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.



Drejtoria për Kulturë Rini e sport

Drejtoresha *Liridona Misinaj*